VENDIM
Nr. 663, datë 12.11.2025

PËR KRITERET, PROCEDURAT E PRANIMIT, TITULLIMIT E TË GRADIMIT TË USHTARAKUT NË SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 125/2024, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë", dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve, procedurave të pranimit, titullimit e të gradimit të ushtarakut në shërbimin ushtarak rezervist për sigurimin e individëve të trajnuar për kompletimin e strukturës së Forcave të Armatosura (FA) për ruajtjen e nivelit të gatishmërisë në sigurinë e vendit.

2. Kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim zbatohen për rekrutimin e ushtarakëve, që kanë shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv dhe për shtetasin civil, i cili nuk ka shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv.

II. KRITERET E PRANIMIT NË SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

Pranohet në shërbimin ushtarak rezervist:

a) ushtaraku që ka dalë në rezervë nga shërbimi aktiv;

b) shtetasi civil që nuk ka qenë më përpara pjesë e shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura dhe plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 1, të nenit 6, të ligjit nr. 125/2024, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist në Republikën e Shqipërisë".

III. PROCEDURAT E PRANIMIT

1. Strukturat e Forcave të Armatosura paraqesin në Shtabin e Përgjithshëm nevojat për kompletim me personel ushtarak rezervist, brenda muajit janar të çdo viti.

2. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, mbi bazën e nevojave dhe kërkesave, harton planin vjetor për kompletim me personel rezervist.

3. Aplikimi për pranim në shërbimin ushtarak rezervist bëhet nëpërmjet procedurës së rekrutimit, si më poshtë vijon:

a) Ushtaraku në shërbimin në rezervë apo shtetasi, që dëshiron të bëhet pjesë e shërbimit ushtarak rezervist aplikon pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit;

b) Aplikantët plotësojnë formularët e aplikimit dhe të pranimit të dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar.

4. Procedura, kriteret, dokumentacioni dhe rregullat e përzgjedhjes bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Dokumentacioni për aplikim është, si më poshtë vijon:

a) Kërkesë me shkrim;

b) Fotokopje e noterizuar e dëftesës/diplomës së shkollës/universitetit, për shtetasit e tjerë, që dëshirojnë të rekrutohen si rezervist;

c) Vërtetim i lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, nga prokuroria e rrethit, vërtetim i gjendjes gjyqësore, dëshmi penaliteti, origjinal ose fotokopje e noterizuar;

ç) Formularë të vetëdeklarimit gjyqësor;

d) Dokument i aftësisë për punë i qendrës shëndetësore, lëshuar nga mjeku i familjes.

6. Përzgjedhja, komisionet dhe përbërja e tyre është, si më poshtë vijon:

a) Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga komisionet e vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin ushtarak rezervist, komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore dhe nga komisioni i shqyrtimit të ankesave;

b) Komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin ushtarak rezervist funksion çdo vit kalendarik pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit;

c) Komisioni i shqyrtimit të ankesave ngrihet pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit për verifikimin e ankesave të paraqitura;

ç) Komisioni i vlerësimit për kandidatët oficerë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ndërsa komisioni i vlerësimit për kandidatët nënoficerë dhe ushtarë/detarë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

d) Komisioni i shqyrtimit të ankesave për kandidatët oficerë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, ndërsa komisioni i shqyrtimit të ankimit për kandidatët nënoficerë dhe ushtarë/detarë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

dh) Në përfundim të procedurës së vlerësimit dhe ankimit, Qendra e Personel-Rekrutimit dërgon listat e kandidatëve fitues në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

e) Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura përgatit praktikën për miratimin e listës së kandidatëve fitues. Lista e kandidatëve fitues oficerë i përcillet për miratim ministrit të Mbrojtjes, ndërsa lista e kandidatëve fitues, nënoficerë dhe ushtarë/detarë, i përcillet për miratim shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

ë) Pas miratimit, vijon procedura për titullimin ushtarak rezervist dhe emërimin në detyrë të kandidatëve fitues, sipas legjislacionit në fuqi për Forcat e Armatosura.

IV. TITULLIMI DHE GRADIMI I USHTARAKUT DHE SHTETASIT NË SHËRBIMIN USHTARAK REZERVIST

1. Shtetasi shqiptar, që nuk ka qenë më përpara pjesë e shërbimit aktiv dhe pranohet në shërbimin ushtarak rezervist, ditën e titullimit “ushtar”, “nënoficer” dhe “oficer rezervist”, kryen betimin ushtarak. Formula e betimit përcaktohet në legjislacionin për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Ushtaraku në rezervë, me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, titullohet dhe i jepet grada ushtarake, që ai ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura.

3. Titullimi “oficer rezervist” dhe dhënia e gradave madhore për oficerët me grada madhore bëhet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

4. Titullimi “oficer rezervist” dhe dhënia e gradës ushtarake për oficerët deri në “kolonel/ kapiten i rangut të parë” bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm ose të komandantit të Forcave të Armatosura në kohë lufte.

5. Titullimi “nënoficer rezervist” dhe dhënia e gradës ushtarake deri “kryekapter” bëhet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit.

6. Titullimi “ushtar/detar rezervist” dhe dhënia e gradës së parë ushtarake bëhet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit.

7. Gradat e tjera për ushtarët/detarët rezervistë jepen nga:

a) shefi i Shtabit të Përgjithshëm për ushtarët/detarët, që shërbejnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe në strukturat e vartësisë së tyre, me propozim të drejtuesit të strukturës së vartësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes ose të Shtabit të Përgjithshëm;

b) komandanti i forcës dhe komandanti i strukturës mbështetëse për strukturën, që drejton dhe ato të vartësisë, me propozim të drejtuesit të strukturës së vartësisë.

8. Ushtarakët në shërbimin rezervistë, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë/detarë kanë të drejtën e gradimit të radhës kur plotësojnë kriteret e përgjithshme të gradimit, arsimimit dhe kualifikimit, të përcaktuara në krerët V e VI të këtij vendimi.

9. Titujt dhe gradat e ushtarakëve në rezervë janë të njëjta me ato që parashikohen në aktet ligjore në fuqi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura.

10. Gradimi, sipas këtij vendimi, bëhet në përputhje me nevojat organike dhe kapacitetet e strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përballimin e gjendjes së krijuar.

V. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR PËRPARIMIN NË GRADË

1. Ushtaraku i shërbimit në rezervë merret në shqyrtim për marrjen e gradës së radhës, kur plotëson këto kritere:

a) Ka plotësuar kohën minimale të qëndrimit në shërbimin në rezervë, sipas kreut VI të këtij vendimi;

b) Ka kryer arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm për marrjen e gradës së radhës;

c) Më shumë se gjysma e vlerësimeve, gjatë qëndrimit në shërbimin në rezervë, nuk është më e ulët se "kënaqshëm";

ç) Është i aftë fizikisht dhe në gjendje të mirë shëndetësore.

2. Emërtimi, kohëzgjatja dhe programi i arsimimit e kualifikimit për marrjen e gradës së radhës miratohen nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

3. Kurset dhe kualifikimet e kërkuara për personelin ushtarak në rezervë, që shërben në strukturat e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të Policisë Ushtarake (seksioni kriminal), njësohen me kurset dhe kualifikimet e kërkuara për marrjen e gradave, sipas këtij vendimi, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

4. Mënyra dhe formati i vlerësimit për periudhën e qëndrimit në shërbimin rezervë është e njëjtë me atë të shërbimit aktiv. Vlerësimi i jepet ushtarakut në përfundim të çdo periudhe aktivizimi në shërbimin rezervë.

5. Plotësimi i kushteve për përparimin në gradë verifikohet nga Qendra e Personel-Rekrutimit, e cila bën edhe propozimet përkatëse tek autoriteti kompetent ose tek autoriteti propozues, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të kreut VI të këtij vendimi.

6. Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij kreu, miraton rregulloren e aftësive fizike, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

VI. KOHA MINIMALE E QËNDRIMIT NË SHËRBIMIN NË REZERVË PËR MARRJEN E GRADËS SË RADHËS

1. Ushtarakët rezervistë të Forcave të Armatosura, për të fituar gradën e radhës, plotësojnë kriteret e qëndrimit në shërbimin në rezervë, si më poshtë vijon:

a) Oficerët:

i. "nëntogeri/nënlejtënanti," për të fituar gradën "toger/lejtënant", është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 3 (tri) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 42 (dyzet e dy) ditë;

ii. togeri/lejtënanti, për të fituar gradën "kapiten/kapitenlejtënant", është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 4 (katër) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë;

iii. "kapiteni/kapitenlejtënanti", për të fituar gradën "major/kapiten i rangut të tretë", është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 5 (pesë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) ditë;

iv. "majori/kapiten i rangut të tretë", për të fituar gradën "nënkolonel/kapiten i rangut të dytë", është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 6 (gjashtë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 84 (tetëdhjetë e katër) ditë;

v. "nënkoloneli/kapiten i rangut të dytë", për të fituar gradën "kolonel/ kapiten i rangut të parë", është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 5 (pesë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) ditë;

vi. “koloneli/kapiteni i rangut të parë, për të fituar gradën “gjeneral brigade/ kundëradmiral”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 5 (pesë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) ditë;

vii. “gjeneral brigade/kundëradmirali”, për të fituar gradën “gjeneralmajor/ nënadmiral”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 3 (tri) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 42 (dyzet e dy) ditë;

viii. “gjeneralmajori/nënadmirali”, për të fituar gradën “gjenerallejtënant/ admiral”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 3 (tri) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 42 (dyzet e dy) ditë.

b) Nënoficerët:

i. “ushtari/detari IV”, për të fituar gradën “nëntetar”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 2 (dy) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 28 (njëzet e tetë) ditë;

ii. “nëntetari”, për të fituar gradën “tetar”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 3 (tri) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 42 (dyzet e dy) ditë;

iii. “tetari”, për të fituar gradën “rreshter”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 4 (katër) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë;

iv. “rreshteri”, për të fituar gradën “kapter”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 6 (gjashtë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 84 (tetëdhjetë e katër) ditë;

v. “kapteri”, për të fituar gradën “kryekapter”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 5 (pesë) periudha vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) ditë.

c) Ushtarët:

i. “ushtari/detari I”, për të fituar gradën “ushtar/detar II”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 1 (një) periudhë vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 14 (katërmbëdhjetë) ditë;

ii. “ushtari/detari II”, për të fituar gradën “ushtar/detar III”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 1 (një) periudhë vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 14 (katërmbëdhjetë) ditë;

iii. “ushtari/detari III, për të fituar gradën “ushtar/detar IV”, është aktivizuar dhe ka shërbyer në strukturat rezerviste, jo më pak se 1 (një) periudhë vjetore, si dhe ka shërbyer në këto struktura, jo më pak se 14 (katërmbëdhjetë) ditë.

2. Për qëllime të këtij vendimi, koha e kryerjes së kurseve të arsimimit ose të kualifikimit, për efekt të fitimit të gradës së radhës, konsiderohet si kohë e qëndrimit në shërbim në rezervë.

3. Përparimi në gradë në shërbimin ushtarak rezervist për oficerët deri në gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë” dhe për nënoficerët deri në gradën “kapter”, që kryejnë detyra organike në specialitete në strukturat e Forcave të Armatosura, bëhet duke u bazuar vetëm në kriterin kohor të qëndrimit në shërbimin ushtarak rezervist dhe jo sipas kritereve të arsimimit dhe kualifikimit, në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 170, datë 28.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve të gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në rezervë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku